VENDIM
Nr. 42, datë 23.9.2016

PËR LICENCIM SHA UJËSJELLËS-KANALIZIME KUKËS

Në mbështetje të nenit 14, pika 1/a, nenit 17 të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", si dhe VKM-së nr. 958, datë 6.5.2009, "Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licence", Komisioni Kombëtar Rregullator,

VENDOSI:

1. Rinovim licence operatorit sh.a. Ujësjellës Kanalizime Kukës, me:
Drejtues ligjor: Gëzim Shehu
Drejtues teknik: Afrim Petku
2. Operatori sh.a. Ujësjellës-Kanalizime Kukës autorizohet të kryejë veprimtarinë përkatëse të kualifikuar në kategoritë:
Kategoria A, Për grumbullimin dhe shpër-ndarjen e ujit për konsum publik;
Kategoria C, Për largimin e ujërave të ndotura.
3. Zona e shërbimit të këtij operatori është Bashkia Kukës.
4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 4-vjeçare (katërvjeçare).
Shfuqizohet vendimi nr. 18, datë 12.5.2015 "Licencimi sh.a. Ujësjellës-Kanalizime Kukës".

KRYETARI
Ndriçim Shani